



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



SHËRBIMI PËRMBARIMOR "ASTREA"

Nr.6189/1Prot

Tiranë, më 28.06.2019

Nr.130-19 Regj.

URDHËR

PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendrës Kombëtare e Biznesit

TIRANË

Për dijëni: **Kreditorit** – Studio Përmbarrimore "KREON" shpk. Nipt: L21303504J

Adresa: Lagjja 11, Blv. kryesor, ish kinema "Iliria", kati 2, Durrës

Për dijëni: **Debitorit**– Shoqëria "Alb Golem" shpk, Nipt: K43420801E

Adresa : Golem Lagjja Kryemëdhej, Rruga e Gjuzëve, ndërtesë private Nr.7, kati 1, Kavajë

Unë, Ardit Hajdini, Përmbarrues Gjyqësor pranë Shërbimit Përmbarrimor "ASTREA" shpk Nipt: L61306025U, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.12-2017-280/31 Vendimi datë 20.02.2017 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Kavajë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarrimore Nr.130-17, datë 20.03.2017 kërkesën e kreditorit Studio Përmbarrimore "KREON" shpk. Nipt: L21303504J ndaj debitorit Shoqëria "Alb Golem" shpk, Nipt: K43420801E në lidhje me titullin ekzekutiv Nr.12-2015-1472/427 Vendimi datë 22.09.2015 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.1591 Prot, Datë 21.03.2017, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhëri i Ekzekutimit Nr.12-2017-280/31 Vendimi datë 20.02.2017 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Kavajë, në referim të neneve 517

Adresa: Rr. "Kajo Karafili", Pallati pas Lidhjes te Shkrimtarëve, Hyrja 1, Kati 2, Zyra nr.1004, Tiranë Cel
+355 676950155

e-mail : sherbimipermbarrimorastrea@gmail.com

dhe 518 të K.Pr.Civile, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile, kam kaluar në Vënie Sekuestro mbi pasuritë e tij.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA se :

Me urdhër Nr.1744 Prot, datë 03.04.2017 është Urdhëruar Vendosia e Sekuestros Konservative pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në aktivet e debitorit Shoqëria "Alb Golem" shpk, Nipt: K43420801E.

Me date 28.06.2019 me kërkesën e kreditorit, nga ana e përmbaruesit gjyqësor Ardit Hajdini është marrë Vendimi për Zgjidhjen e Kontratës së Shërbimit të datës 20.03.2017 dhe në zbatim të nenit 12 pika 1/d të Kontratës së Shërbimit, nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit Nr.10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. ***Heqjen e masës së Sekuestros Konservative***, të vendosur me anë të Urdhërit Nr.1744 Prot, datë 03.04.2017 në aktivet e debitorit:

- **Shoqëria "Alb Golem" shpk, Nipt: K43420801E**

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju bëj me dije se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile dhe Udhëzimin Nr. 2 datë 27.03.2014 të Bankës së Shqipërisë, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.
- c) Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje.

**SHËRBIMI PËRMBARIMOR "ASTREA"
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ARDIT HAJDINI**



Adresa: Rr. "Kajo Karafili", Pallati pas Lidhjes te Shkrimtarëve, Hyrja 1, Kati 2, Zyra nr.1004, Tiranë Cel
+355 676950155

e-mail : sherbimipermbarimorastrea@gmail.com